



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1773₁ / prot.

Tiranë më 29.10.2021

Lënda: Mëndim mbi “Traktatin Ndërkombëtar për Shkëmbimin e të Dhënave për Verifikimin e Deklaratës së Pasurive”

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.5211 prot., datë 20.10.2021, me anë të së cilës përcillni për njohje dhe vlerësim kërkesën për nënshkrimin dhe anëtarësimin në “*Traktatin Ndërkombëtar për Shkëmbimin e të Dhënave për Verifikimin e Deklaratës së Pasurive*”, lutemi referojuni vlerësimit në vijim.

Nga sa informohemi nga ana juaj, kërkesa për nënshkrimin e Traktatit të sipërpërmendur është ndërmarrë nga organizata Iniciativa Rajonale Antikorrupsion (RAI) në kuadër të forcimit rajonal dhe ndërkombëtar të vendeve të Ballkanit Perëndimor për parandalimin e korrupsionit nëpërmjet shkëmbimit të drejtpërdrejtë administrativ të informacionit të deklaratave të pasurisë.

Sikurse jeni në dijeni, bazuar në Vendimin nr.8, datë 31.10.2016 të Komisionerit “*Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale*”, konsiderohen vend me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, ata vende të cilat janë pjesë e listës të këtij vendimi. Në çdo rast tjetër, nevojitet që për legjitimitimin e procesit të transferimit ndërkombëtar të të dhënave të plotësohet njëri nga kushtet e parashikuara në pikën 2, të nenit 8, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar, (në vijim “*Ligji*”).

Në rastin konkret, jo të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor apo anëtar të RAI janë vende të cilat konsiderohen si vende me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.

Por pavarësisht këtij fakti, shkëmbimi i të dhënave në këtë rast do të realizohet me anë të një Traktati ndërkombëtar i cili do t’i nënshtrohet instrumenteve të ratifikimit, pra edhe nëse transferimi i të dhënave do të bëhet në një shtet i cili nuk konsiderohet sipas legjislationit vend me nivel të mjaftueshëm i mbrojtjes së të dhënave, instrumenti ligjor që palët/shtetet do të përdorin, legjitimohet pasi ndodhemi para kushteve të nenit 8, pika

2/a e ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar ku parashikohet se transferimi ndërkombëtar realizohet nëse autorizohet nga akte ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe që janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Për sa më sipër, vlerësojmë që forma e instrumentit juridik të bashkëpunimit (Traktat Ndërkombëtar) plotëson kushtet ligjore dhe është konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Sa i përket përmbajtjes së këtij Traktati sugjerojmë disa ndërhyrje të cilat konsistojnë në nenet e mëposhtme.

Në pikën 3, të nenit 3 togfjalëshi “...një Pikë Kontakti mund t'i ofrojë në mënyrë vullnetare...” sugjerojmë të riformulohet. Kjo pasi, duke i dhënë këtë kompetencë Pikës së Kontaktit termi “*ofrimi në mënyrë vullnetare të informacionit*” mund të krijojë keqinterpretime ligjore. Bazuar në legjislacionin shqiptar mbrojtja e të dhënave personale është parashikuar në nenin 35 të Kushtetutës. Gjithashtu, sipas parashikimeve të nenit 5 dhe 6 të Ligjit, përpunimi i dhënave personale duhet të kryhet vetëm në zbatim të parashikimeve konkrete të ligjit ose në kundërt, në pikën 3 të këtij neni, duhet të saktësohet se cilat do të jenë kategoritë e informacionit që mund të ofrohet vullnetarisht nga Pika e Kontaktit.

Pas pikës 1 të nenit 9, sugjerojmë të shtohen dy paragrafe me këtë përmbajtje:

“(Masat e Sigurisë) Palët do të ndërmarrin masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

“(Koha e ruajtjes) Informacioni i shkëmbyer nga palët mbahet për një kohë por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin është grumbulluar apo përpunuar më tej.”

Gjithashtu, konstatojmë një gabim materjal: Në germën f) të nenit 2, sugjerojmë saktësimin e referencës “...sipas nenit 9” në “sipas nenit 10”.

Në përfundim, me përfshirjen e parashikimeve të sugjeruara më sipër, traktati vlerësohet i hartuar konform ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi